

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-242-13**

**Prishtinë,  
23 April 2014**

Në çështjen juridike të:

**V.M**

***Pala ankuese***

kundër.

**Nuk dihet**

***Pala përgjegjëse në ankesë***

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Dag Brathole, Kryetar i Kolegjit, Elka Filcheva – Ermenkova dhe Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/188/2013, të datës 13 shtator 2013 (lënda është regjistruar në AKP me numër KPA34249, KPA34251, KPA34253, KPA34256, KPA34263, KPA34265, KPA34266, KPA34267, KPA34268) , pas shqyrtimit të mbajtur më 23 prill 2014, mori këtë:

**AKTGJYKIM:**

1. Lëndët prej GSK-KPA-A-242-13 deri GSK-KPA-A-250/13 bashkohen në një lëndë të vetme me numrin GSK-KPA-A-242-13.
2. Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/188/2013, i datës 13 shkurt 2013 (lënda është regjistruar në AKP me numrat KPA34249, KPA34251, KPA 34253, KPA34256, KPA34263, KPA34265, KPA34266, KPA34267 dhe KPA34268) si dhe hidhen poshtë kërkesat e Vladan Mihajlović-it pasi nuk bien në kuadër të fushëveprimit të juridiksionit të KKPK-së.

**Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Më 20 prill 2007, V.M ka paraqitur nëntë kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e pronësisë/të drejtës pronësore mbi nëntë ngastra që ndodhen në Krushë të Madhe dhe Celinë në Rahovec, dhe në Randobravë në Prizren.
2. V.M ka deklaruar në ato kërkesa se i ndjeri gjyshi i tij D.M është pronar i këtyre pronave. Si provë ai ka sjellë Certifikatën/Vendimin për ndarjen e pronës nr. 523 i datës 1 tetor 1939 lëshuar nga Komisioni për Reformën Agrare, që është siguruar nga arkivat e Beogradit. Në bazë të certifikatës, D.M i janë ndarë pronat e kërkuara në vitin 1939.
3. Kërkesat janë regjistruar si nëntë lëndë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP). Siç do të ceket më vonë, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) ka marrë vendime për nëntë lëndët, dhe të gjitha vendimet janë kundërshtuar në Gjykatën Supreme, ku ankesat janë regjistruar sikurse nëntë lëndët. Tabela në vijim e paraqet pasqyrën e numrave të lëndëve në AKP, numrave të lëndëve në Gjykatën Supreme, komunën, zonën kadastrale dhe numrin e ngastrës.

<i>Numri i lëndës në AKP</i>	<i>Numri i lëndës në Gjykatë Supreme</i>	<i>Komuna</i>	<i>Zona kadastrale</i>	<i>Nr. i ngastrës</i>
KPA34249	GSK-KPA-A-242/13	Rahovec	Krushë e Madhe	132
KPA34251	GSK-KPA-A-243/13	Rahovec	Krushë e Madhe	134/1 134/2

KPA34253	GSK-KPA-A-244/13	Rahovec	Krushë e Madhe	113
KPA34256	GSK-KPA-A-245/13	Rahovec	Krushë e Madhe	77
KPA34263	GSK-KPA-A-246/13	Prizren	Randobravë	562
KPA34265	GSK-KPA-A-247/13	Prizren	Randobravë	570
KPA34266	GSK-KPA-A-248/13	Prizren	Randobravë	571
KPA34267	GSK-KPA-A-249/13	Prizren	Randobravë	569
KPA34268	GSK-KPA-A-250/13	Rahovec	Celinë	698

4. Në kërkesa është cekur se pronat janë humbur më 15 qershor 1999 si rezultat i rrethanave në vitet 1998/1999 në Kosovë.
5. AKP-ja, *ex officio*, e ka siguruar fletat poseduese të lëshuara nga Drejtoria Komunale për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Rahovec dhe Celinë, dhe certifikatat e lëshuar nga Ministria e Shërbimeve Publike, Agjencia Kadastrale e Kosovës. Këto dokumente ofrojnë informatat në vijim lidhur me ngastrat e referuara në kërkesa:

<i>Nr. rendor</i>	<i>Nr. i zonës kadastrale</i>	<i>Zona kadastrale</i>	<i>Sipërfaqja</i>	<i>Nr. i ngastrës</i>	<i>Bartësi i regjistruar i së drejtës së pronës</i>	
19	7151300 5	Krushë e Madhe	2 225 m <sup>2</sup>	132	SH.D.SH	
25	7151300 5	Krushë e Madhe	1 098 m <sup>2</sup>	134/1 134/2	D.S.SH	
9	7151300 5	Krushë e Madhe	539 m <sup>2</sup>	113	I.R.R	
61	7151300 5	Krushë e Madhe	1 905 m <sup>2</sup>	77	Z.E.L.B	
	7181306 9	Randobravë/	700	562	M.B.K	
	7181306 9	Randobravë/	8 173 m <sup>2</sup>	570	A.S.K	
	7181306 9	Randobravë	2 158	570	M.S.Z	
	7181306 9	Randobravë	1 079	569	J.J.SH Sh.Xh.J.	1/2 1/2
33	7151308 3	Celinë	2 052 m <sup>2</sup>	698	M.A.D M.R.D R.N.D R.A.D R.R.D Sh.H.D SH.A.D V.N.D	4/36 6/36 3/36 4/36 4/36 6/36 4/36 3/36

6. Njoftimi i kërkesave është bërë në pronë. Asnjë palë përgjegjëse në kërkesë nuk i ka kontestuar kërkesat brenda afatit të paraparë.
7. Më 13 shkurt 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) përmes vendimit grupor KPCC/D/A/188/2013 (lëndët e regjistruara në APK me numrat KPA34249, KPA34251, KPA 34253, KPA34256, KPA34263, KPA34265, KPA34266, KPA34267, dhe KPA34268), ka refuzuar kërkesat. KKPK-ja ka cekur se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë pronësinë apo çfarëdo të drejte pronësore ndaj pronave të kërkuara menjëherë para apo gjatë konfliktit në vitet 1998-1999.
8. Vendimi i është dorëzuar V.M më 12 gusht 2013. Ai i ka kundërshtuar të nëntë vendimet me një ankesë të datës 21 gusht 2013. Nuk ka asnjë palë përgjegjëse në këtë lëndë, po ashtu edhe asnjë palë përgjegjëse në ankesë. Gjykata Supreme ka pranuar lëndën më 21 shkurt 2014.

#### **Pretendimet e palës ankuese**

9. V.M e kundërshton vendimin mbi bazën e gabimit thelbësor dhe zbatimit të gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale në fuqi, si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të fakteve.
10. Pronat janë në pronësi të gjyshit të V.M, D.M, i cila ka vdekur më 28 prill 1947. V.M ka paraqitur kërkesë si anëtar i familjes së ngushtë.
11. Në vendimin e KKPK-së ceket se KPA-ja, *ex officio*, ka kontrolluar dhe konfirmuar se disa palë të treta kanë të drejtën pronësore mbi pronat në fjalë. Sidoqoftë, V.M deklaroi se këta persona nuk kanë bazë ligjore për ta pasur në shfrytëzim pronën e familjes V.M. Ata janë duke e shfrytëzuar pronën ilegalisht. As D.M, as babai i tij, dhe asnjëri nga axhët e V.M nuk kanë lidhur kontratë me ndonjë person të tretë.
12. Prandaj, asnjë person i tretë, nuk e ka blerë ndonjërin nga pronat, të cilat ende i përkasin familjes M..

#### **Bashkimi i lëndëve**

13. V.M ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së për lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA34249, KPA34251, KPA 34253, KPA34256, KPA34263, KPA34265, KPA34266, KPA34267 dhe KPA34268. Lëndët janë paraqitur në Gjykatën Supreme si lëndë me numrat prej GSK-KPA-A-242-13 deri GSK-KPA-A-250/13. Të gjitha lëndët kanë të bëjnë me kërkesat e paraqitësit të njëjtë të kërkesave. Nuk ekziston asnjë palë përgjegjëse në kërkesë. Lëndët kanë të bëjnë me çështjen e njëjtë. Bashkimi i lëndëve do të kontribuonte në efikasitetin e procedurës.
3. Prandaj, Gjykata Supreme lëshon një urdhër për të bashkuar lëndët me numrat prej GSK-KPA-A-242-13 deri GSK-KPA-A-250/13 në një lëndë të vetme të regjistruara me numrin GSK-KPA-A-242-13 në pajtim me Ligjin për Procedurën Kontestimore, neni 408.1 dhe neni 193, të cilët aplikohen *mutatis mutandis*, në përputhje me nenin 12.2 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme Ligji nr. 03/L-079).

### **Arsyetimi ligjor:**

#### *Pranueshmëria e ankesës*

14. Ankesa është pranueshme, pasi që ajo është paraqitur brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079).

#### *Juridiksioni*

15. Gjatë përgatitjes së lëndës për KKPK-në, AKP-ja ka siguruar fletat poseduese dhe certifikatat e përmendura në paragrafin 5. Këto tregojnë se të gjitha pronat janë të regjistruara në emër të palëve të treta të ndryshme.
16. Gjatë verifikimit të fletëve poseduese/certifikatave, AKP-ja ka konstatuar se D.M nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar si posedues i ndonjërit nga pronat. AKP-ja po ashtu ka konstatuar se të gjithë poseduesit e regjistruar kishin qenë të regjistruar qysh para konflikti i armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999. Bazuar në këto fakte, KKPK-ja ka refuzuar kërkesat sepse V.M nuk ka arritur të dëshmojë pronësinë apo të drejtën për shfrytëzimin e pronave.

17. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, KKKP-ja ka kompetencë që të zgjidh kërkesat që ndërlidhën me konfliktin lidhur me pronësinë apo të drejtën e shfrytëzimit mbi pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale. KKKP-ja është kompetente vetëm kur kërkesat ndërlidhen drejtpërsëdrejti me rrethanat ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
18. Në lëndën aktuale, është vërtetuar se palët e treta janë të regjistruara si bartëse të së drejtës pronësore para vitit 1998. Kështu që, konflikti në mes të V.M dhe bartësve të regjistruar të së drejtës pronësore, nuk është i ndërlidhur me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë, ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Prandaj, kërkesa nuk është në kuadër të juridiksionit të KKKP-së.
19. Dhe, një kontest në mes të V.M dhe bartësve të regjistruar të së drejtës pronësore do të duhej të zgjidhej në gjykatat e rregullta në Kosovë.
20. Në bazë të të lartcekurave dhe në përputhje me nenin 12.2 nën (c) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 198.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), u vendos të anulohet vendimi i KKKP-së si dhe të hidhet poshtë kërkesa.

### **Këshillë ligjore**

21. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

**Dag Brathole, Kryetar i Kolegjit, EULEX**

**Elka Filcheva Ermenkova, Gjyqtar i EULEX-it**

**Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar**

**Urs Nufer Referenti i EULEX-it**